




# PROPOZIM PËR FUTJEN E DHUNËS KIBERNETIKE NË KODIN PENAL TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS



# Propozimet për futjen e Dhunës Kibernetike në Kodin Penal të Republikës së Kosovës



## Hyrje

Në prill të vitit 2024, Bashkimi Europian votoi Direktivën për Luftimin e Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje<sup>1</sup>, duke shënuar një hap vendimtar drejt garantimit të sigurisë dhe mbrojtjes së grave dhe vajzave në të gjitha sferat e jetës, duke përfshirë edhe online. Kjo përmbledhje politikash synon të informojë procesin e ndryshimit të Kodit Penal duke theksuar nevojën për përkufizime dhe dënime të harmonizuara për dhunën kibernetike.

## Argumentet Justifikuese

Sipas UNDP-së, në nivel global, 38% e grave kanë përjetuar drejtpërdrejt abuzim në internet dhe 50% e vajzave përballen më shumë me ngacmime në internet sesa me ngacmime në rrugë.<sup>2</sup> Në Kosovë, është e vështirë të dihet numri i rasteve të dhunës kibernetike, sepse nuk ka një përcaktim të qartë ligjor.<sup>3</sup> Mungesa e përcaktimeve të qarta në kodin penal të drejtëpërdrejtë pengon raportimin dhe dokumentimin e rasteve, duke lejuar shkeljen e të drejtave. Hulumtimi i RrGK-së zbuloi se “mungesa e mekanizmave të qartë për trajtimin e individëve që përdorin gjuhën e urrejtjes online dhe nxisin dhunë mund të kontribuonte në pa pëlqimin e viktimave për të raportuar shkeljet.”<sup>4</sup> Dhuna kibernetike mund të ketë efektin e heshtjes së grave dhe vajzave dhe mund të hap dyert për forma të tjera të dhunës në të ardhmen. Sipas Direktivës, dhuna kibernetike prekë më shumë gratë dhe vajzat dhe specifikisht “gratë politikane, gazetare dhe mbrojtëset e të drejtave të njeriut”.<sup>5</sup> Dhuna kibernetike gjithashtu prek në mënyrë disproporcionale gratë dhe vajzat në mjediset arsimore, si shkollat dhe universitetet, me pasoja të dëmshme për arsimimin e tyre të mëtejshëm dhe për shëndetin mendor, shkakton përjashtim social, ankth dhe nxitje për të shkaktuar vetëdëmtim dhe në raste ekstreme mund të çojë në vetëvrasje.<sup>6</sup> Ndërsa pozita e pabarabartë e grave dhe vajzave në shoqëri dhe përvoja e përgjithshme e diskriminimit dhe ngacmimit me bazë gjinore i bën ato viktimat më të mundshme të këtij krimi. Burrat dhe djemtë gjithashtu mund të vuajnë nga ngacmimi në internet, duke e bërë atë një çështje kritike për t'u trajtuar për të gjithë shoqërinë.

Prandaj, duhet të sigurohen përkufizime të veprave penale dhe dënimeve në lidhje me forma të caktuara të dhunës kibernetike ku dhuna është e lidhur thelbësisht me përdorimin e Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit (TIK) dhe këto teknologji përdoren për të përforcuar ndjeshëm ashpërsinë e ndikimit të dëmshëm të veprës penale, duke ndryshuar kështu karakteristikat e veprës penale.

Ekzistojnë përvoja përkatëse ndërkombëtare. Disa vende kanë filluar të përfshijnë forma të dhunës kibernetike në legjislacionet e tyre me qëllim parandalimin, ndjekjen dhe ndëshkimin e kësaj forme të krimit. Shtetet si Kanada, Zelanda e Re dhe Britania e Madhe kanë krijuar akte të veçanta dhe kanë plotësuar aktet e tyre ekzistuese me norma që rregullojnë dhunën kibernetike. **Kanada** ka amadamentuar kodin e saj penal duke shtuar një vepër të re penale për shpërndarjen e paautorizuar të imazheve intime dhe autorizon heqjen e tyre nga interneti, si dhe kërkon konfiskimin e pronës/paisjes së përdorur për këtë vepër. Kjo vepër është e dënueshme me deri në dy vite burgim.<sup>7</sup> Edhe **Zelanda e Re** ka përditësuar legjislacionin e saj duke krijuar Ligjin për Komunikimet Digjitale të Dëmshme në vitin 2015<sup>8</sup> i cili ka për qëllim mbrojtjen e individëve nga përmbajtjet digjitale që shkaktojnë efekte të dëmshme. Ky ligj synon të parandalojë dhe të adresojë situatat ku individët ekspozohen ndaj

<sup>1</sup> [Direktiva e BE-së për Luftimin e Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje.](#)

<sup>2</sup> UNDP Evropë dhe Azia Qendrore, [Dhuna kibernetike pamundëson gratë dhe vajzat dhe kërcënon të drejtat e tyre themelore](#), 2021.

<sup>3</sup> Rrjeti i Grave të Kosovës, [Barazia Gjinore dhe TI: Analiza Gjinore e Digjitalizimit në Kosovë](#), 2024.

<sup>4</sup> Po aty., f. 457.

<sup>5</sup> [Direktiva e BE-së për Luftimin e Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje](#), f. 14.

<sup>6</sup> Po aty., f. 14.

<sup>7</sup> Faqja e internetit e qeverisë së Kanadasë për Ligjet e Drejtësisë, [Mbrojtja e Kanadezëve nga Akti i Krimit në internet](#), Seksioni 4, 2014.

<sup>8</sup> Faqja zyrtare e qeverisë së Zelandës së Re, [Ligji i Komunikimeve Digjitale të Dëmshme i vitit 2015](#), versioni me 9 mars 2022

mesazheve, postimeve ose përmbajtjeve online që mund të shkaktojnë stres të rëndë, dëmtim të reputacionit ose ndjesi të tjera negative. Në **Britani të Madhe** janë përfshirë disa forma të dhunës kibernetike në kuadër të Ligjit për kundërvajtje seksuale 2003<sup>9</sup>, ku janë përfshirë Dërgimi i Fotografive ose Filmit të organeve gjenitale, Shpërndarja ose Kërcënimi për Shpërndarjen e Fotografive Intime, dhe Voyeurizmi<sup>10</sup>. Këto vepra janë të dënueshme me deri në dy vite burg.

Në **BE**, Direktiva për Luftimin e Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje thekson rrezikun e shkaktoimit të dëmeve në mënyrë të lehtë, të shpejtë dhe të gjerë përmes përdorimit të TIK, e cila mund të ndikojë tek shumë individë. Direktiva vendos rregulla minimale për trajtimin e dhunës kibernetike serioze, duke u përqendruar në veprimet që ka të ngjarë të shkaktojnë dëme të mëdha ose frikë për sigurinë e viktimës. Rrethanat specifike të secilit rast duhet të merren parasysh, dhe Shtetet Anëtare kanë mundësinë të adoptojnë rregulla më të rrepta përtej këtij kuadri minimal, si dhe të miratojnë ose të krijojnë rregulla më të ashpra penale. Direktiva specifikisht cekë:

*Dispozitat e kësaj Direktive që lidhen me të drejtat e viktimave duhet të zbatohen për të gjitha viktimat e sjelljeve kriminale që përbëjnë dhunë ndaj grave ose dhunë në familje, siç janë kriminalizuar sipas ligjit të Bashkimit Evropian ose ligjit kombëtar. Kjo përfshin veprat penale të përcaktuara në këtë Direktivë, përkatësisht ..., **përndjekja kibernetike, ngacmimi kibernetik, shfaqja e padëshiruar e përmbajtjeve kibernetike dhe nxitja kibernetike e dhunës ose urrejtjes, dhe sjelljen kriminale të mbuluar nga akte të tjera ligjore të Bashkimit, veçanërisht Direktivat 2011/36/BE dhe 2011/93/BE. Së fundmi, disa vepra penale sipas ligjit kombëtar hyjnë në përkufizimin e dhunës ndaj grave. Ato përfshijnë vepra të tilla si femicidi<sup>11</sup>, përdhunimi, ngacmimi seksual, abuzimi seksual, përndjekja, martesë e hershme, aborti i detyruar, sterilizimi i detyruar dhe forma të ndryshme të dhunës kibernetike, si ngacmimi seksual në internet dhe ngacmimi kibernetik.**<sup>12</sup>*

Tutje, Direktiva thotë se:

*Dënimet për veprat penale të përcaktuara në këtë Direktivë duhet të jenë efektive, bindëse dhe proporcionale. Për këtë qëllim, duhet të vendosen nivele minimale për afatin maksimal të burgimit për personat fizikë. Afatet maksimale të burgimit të parashikuara në këtë direktivë për veprat penale të kryera nga personat fizik duhet të zbatohen të paktën për format më të rënda të këtyre veprave*<sup>13</sup>.

Direktiva po ashtu thotë se duhet të ketë një qasje jo ri-viktimizuese, si dhe kërkon që viktimat të kenë mundësi ta raportojnë dhunën e përjetuar në mënyrë fizike por edhe përmes mjeteve të TIK-ut<sup>14</sup>. Kosova duhet të harmonizojë kornizën e saj ligjore me këtë direktivë.

Sipas Kodit Penal aktual të Republikës së Kosovës, në kapitullin për krimet kibernetike (KAPITULLI XXIV/A), veprat janë të dënueshme me gjobë dhe burgim deri në gjashtë vite, varësisht nga natyra dhe serioziteti i krimit. Ndërsa për rastet që përfshijnë materiale me përmbajtje të shfrytëzimit dhe keqpërdorimit seksual të fëmijëve, dënimi mund të arrijë deri në dhjetë vite burgim.<sup>15</sup>

<sup>9</sup> Faqja zyrtare e Mbretërisë së Bashkuar, [legislation.gov.uk](https://legislation.gov.uk), "Ligji për kundërvajtje seksuale 2003", 2024, qasur më 6 gusht 2024.

<sup>10</sup> Filmimi i fshehtë dhe pa pëlqim të dekoltesë, kofshëve ose organeve gjenitale të një gruaje të paimagjinuar në vende publike ose private. Këto foto janë gjithashtu të njohura si "creepshots" - . Voyeurizmi digjital mund të referohet gjithashtu në dërgimin e imazheve seksuale të padëshiruara (shpesh të pjesëve private të tyre) nga autorët, siç është shfaqja kibernetike.

<sup>11</sup> [Instituti European per Barazi Gjinore](#): Femicidi përkufizohet gjerësisht si vrasja e një gruaje ose vajze për shkak të gjinisë së saj dhe mund të marrë forma të ndryshme, si vrasja e grave si rezultat i dhunës nga partneri intim; torturat dhe vrasjet mizogjene të grave; vrasja e grave dhe vajzave në emër të "nderit"; etj.

<sup>12</sup> [DIREKTIVA \(BE\) 2024/1385 E PARLAMENTIT DHE E KËSHILLIT EVROPIAN](#), f. 2.

<sup>13</sup> Po aty.

<sup>14</sup> Po aty.

<sup>15</sup> [Kodit Penal i Republikës së Kosovës, KAPITULLI XXIV/A](#)

Në shtetet ku veprat e dhunës kibernetike janë përfshirë në legjislacionet e tyre, parashikohen dënime me gjobë dhe burgim. Në Kanada dhe Britani të Madhe, këto vepra dënohen me burgim deri në dy vjet.

Për më tepër, sipas përvojës ndërkombëtare,<sup>16</sup> normat, rolet dhe marrëdhëniet gjinore shpesh nuk ndryshojnë ndjeshëm si rezultat i gjobave dhe burgosjes. Këshillimi psikologjik është i nevojshëm për të ndryshuar sjelljet. Kodi Penal aktual, neni 4.2, tashmë parashikon "*masa të trajtimit të detyrueshëm që mund t'i shqiptohen autorit*".<sup>17</sup> Tutje, Strategjia Kombëtare e Qeverisë së Kosovës për Mbrojtjen ndaj Dhunës në Familje dhe Dhunës ndaj Grave 2022-2026 thekson se edukimi i vazhdueshëm, që "synon të transformojë rolet tradicionale gjinore dhe marrëdhëniet e pushtetit, mund të kontribuojë në parandalimin e dhunës". Kjo strategji kërkon gjithashtu "punë me dhunuesit gjatë kohës që janë në burg si pjesë e planeve të menaxhimit të rasteve të tyre, me qëllim transformimin e normave dhe marrëdhënieve gjinore, sfidimin e marrëdhënieve të pushtetit, trajtimin e varësive dhe menaxhimin e zemërimit"; dhe objektivi specifik I.4. është "Zhvillimi dhe zbatimi i programeve për trajtimin psiko-social të dhunuesve". Për të siguruar zbatimin e premtimeve të kësaj Strategjie, me qëllim që të transformohen sjelljet e ndikuara nga gjinia dhe për të parandaluar të gjitha format e dhunës të bazuar në gjini në të ardhmen, Kodi Penal duhet të kërkojë trajtim dhe këshillim psikologjik si pjesë të dënimit minimal të detyrueshëm për **të gjitha rastet e dhunës me bazë gjinore**, duke përfshirë dhunën kibernetike me bazë gjinore. Kjo do të sigurojë që gjyqtarët të përfshijnë këshillimin në dënimet e tyre, duke kontribuar në rehabilitimin e dhunuesve dhe parandalimin e dhunës recidiviste. Për këtë arsye, RrGK rekomandon përfshirjen e këshillimit psikologjik (ne bazë të nenit ekzistues 4.2) në dënimet e detyrueshme për të gjitha format e dhunës të bazuar në gjini, në kodin penal, përfshirë krimet e rënda, femicidin, dhunën në familje, përdhunimin, ngacmimin seksual dhe dhunën kibernetike të bazuar në gjini.

## Propozimet e Definicioneve dhe Denimet

RrGK rekomandon fuqimisht që Kodi Penal i Kosovës të përfshijë të njëjtat "rrethana rënduese" siç parashikon Direktiva, duke shtuar gjithashtu **identitetin gjinor** dhe **shprehjen gjinore**. Në bazë të Direktivës dhe kornizës ligjore ekzistuese të Kosovës, Kosova duhet të inkorporojë në Kodin Penal veprat dhe dënimet e mëposhtme, të marra nga përvojat ndërkombëtare. RrGK propozon që ky nen të vendoset në Kapitullin XXI të Kodit Penal, duke shtuar një nen të ri **Neni 249 Dhuna Kibernetike me Bazë Gjinore**.

### Neni 249 Dhuna Kibernetike ne baza Gjinore

Dhuna kibernetike në baza gjinore përfshinë çdo veprim që ndodh ndaj një personi për shkak të gjinisë së tyre, përmes përdorimit të TIK-ut, mjeteve elektronike, duke përfshirë por pa u kufizuar në rrjetet sociale, postën elektronike, forumet online, dhe platformat e tjera digjitale. Si forma të dhunës kibernetike në baza gjinore janë:

**249. I Përndjekja kibernetike:** Kushdo që mbikëqyr në mënyrë të përsëritur ose e vazhdueshme me anë të TIK-ut, duke përfshirë por pa u kufizuar në rrjetet sociale, postën elektronike, forumet online, dhe platformat e tjera digjitale përndjek personin tjetër pa pëlqimin e tij/saj ose pa autorizim ligjor duke përpunuar të dhëna personale të viktimës, me anë të vjedhjes së identitetit, duke vjedhur fjalëkalime, duke hakërruar pajisjet e viktimës, duke aktivizuar fshehurazi softuerin e regjistrimit të çelësave për të hyrë në hapësirat private të viktimës, duke instaluar aplikacione gjeo-lokalizimi, duke përfshirë softuer për përndjekje, ose duke vjedhur pajisjet e viktimës, dënohet me gjobë dhe burgim prej gjashtë (6) muaj deri në tri (3) vjet burgim.

<sup>16</sup> Në vende të tjera si Suedia dhe Gjermania ekzistojnë praktika që përdorin këshillimin psikologjik nga profesionistë të trajnuar.

<sup>17</sup> [Kodit Penal i Republikës së Kosovës, KAPITULLI XXIV/A, neni 4.2.](#)

1.1. Kur vepra penale nga ky nen kryhet ndaj viktimës nën moshën tetëmbëdhjetë (18) vjet, kryesi dënohet me burgim prej tre (3) deri në gjashtë (6) vjet.

**249.2 Nxitja kibernetike e dhunës ose urrejtjes në baza gjinore:** Kushdo që përmes përdorimit të TIK-ut, mjeteve elektronike, duke përfshirë por pa u kufizuar në rrjetet sociale, postën elektronike, forumet online, dhe platformat e tjera digjitale, publikon ose shpërndanë mesazhe, fotografi dhe video që ka për qëllim promovimin dhe nxitjen e dhunës, urrejtjes, ose diskriminimit ndaj një personi ose grupi personash për shkak të gjinisë së tyre dënohet me gjobë dhe me burgim prej gjashtë (6) muaj deri në 5 vjet burgim.

**249.3 Ngacmimi seksual kibernetikë:** Kushdo që përmes përdorimit të TIK-ut, mjeteve elektronike, duke përfshirë por pa u kufizuar në rrjetet sociale, postën elektronike, forumet online, dhe platformat e tjera digjitale ngacmon seksualisht personin tjetër me qëllim të cenimit të dinjitetit apo që cenon dinjitetin e personit, dhe krijon një mjedis frikësues, armiqësor, degradues ose poshtërues dënohet me burg deri në dy (2) vjet.

Kur vepra penale nga ky nen kryhet ndaj viktimës nën moshën tetëmbëdhjetë (18) vjet, kryesi dënohet me burgim deri në tetë (8) vjet.

**249.4 Kërkim seksual:** Kushdo që përmes përdorimit të TIK-ut, mjeteve elektronike, duke përfshirë por pa u kufizuar në rrjetet sociale, postën elektronike, forumet online, dhe platformat e tjera digjitale synon të përfitojë favore seksuale nga një person tjetër përmes kërkesave të padëshiruara për të folur për seks ose për të bërë diçka seksuale në kontekste të ndryshme online ose fizike si dërgimi i kerkesave, shkrimeve, fotove dhe videove me përmbajtje seksuale dënohet me gjobë dhe burgim deri në dy (2) vite.

Kur vepra penale nga ky nen kryhet ndaj viktimës nën moshën tetëmbëdhjetë (18) vjet, kryesi dënohet me burgim deri në tetë (8) vjet.

**249.5 Poshtërimi për sjellje seksuale:** Kushdo që përmes përdorimit të TIK-ut, mjeteve elektronike, duke përfshirë por pa u kufizuar në rrjetet sociale, postën elektronike, forumet online, dhe platformat e tjera digjitale publikon, shpërndanë mesazheve, imazheve, videove, ose çdo lloj përmbajtjeje tjetër që synon të poshtërojë ose ofendojë një person për shkak të pamjes, sjelljeve ose preferencave të tij seksuale dënohet me gjobë ose burgim deri në një (1) vit.

Kur vepra penale nga ky nen kryhet ndaj viktimës nën moshën tetëmbëdhjetë (18) vjet, kryesi dënohet me burgim deri në pesë (5) vjet.

**249.6 Shfaqja e padëshiruar e përmbajtjes së papërshtatshme në internet ose TIK:** Kushdo që përmes përdorimit të TIK-ut, mjeteve elektronike, duke përfshirë por pa u kufizuar në rrjetet sociale, postën elektronike, forumet online, dhe platformat e tjera digjitale ose duke përdorur Airdrop apo Bluetooth publikon ose shpërndanë mesazhe, fotografi, video, ose çdo lloj përmbajtjeje tjetër intime pa pëlqimin e personit tjetër pa marrë parasysh nëse këto mesazhe, foto ose video mund të jenë marrë me ose pa pëlqimin e personit të paraqitur në to, dënohet me gjobë dhe burgim prej gjashtë (6) muaj deri në tri (tri) vjet.

249.6 (a) Kur vepra penale nga ky nen kryhet ndaj viktimës nën moshën tetëmbëdhjetë (18) vjet, kryesi dënohet me burgim deri në tetë (8) vjet.

**249.7 Falsifikim i thellë ("Deepfake"):** Kushdo që përmes përdorimit të TIK-ut, mjeteve elektronike, duke përfshirë por pa u kufizuar në rrjetet sociale, postën elektronike, forumet online, dhe platformat e tjera digjitale publikon ose shpërndanë media audio ose vizuale të manipuluar ose sintetike që duken autentike dhe që paraqesin njerëz që duket se thonë ose bëjnë diçka që ata kurrë nuk e kanë thënë ose bërë, të prodhuara duke përdorur teknika të

inteligjencës artificiale, me qëllim të mashtrimit, dezinformimit, poshtërimit, shantazhit, ose dëmtimit të reputacionit të një personi, denohet me gjobë dhe burgim prej gjashtë (6) muaj deri në tri (3) vite.

**249.8 Fotografi e padëshiruar poshtë rrobave:** Kushdo që përmes përdorimit të TIK-ut ose mjeteve elektronike fotografon, regjistron ose shpërndanë imazhe të një personi pa pëlqimin ose dijeninë e tij, me fokus të veçantë në pjesët intime ose të mbuluara të trupit të tij denohet me gjobë dhe burgim deri në dy (2) vjet.

Kur vepra penale nga ky nen kryhet ndaj viktimës nën moshën tetëmbëdhjetë (18) vjet, kryesi dënohet me burgim prej tre (3) deri në gjashtë (6) vjet.

**249.9 Zbulimi i informacionit personal (“Doxing”):** Kushdo që përmes përdorimit të TIK-ut, mjeteve elektronike, duke përfshirë por pa u kufizuar në rrjetet sociale, postën elektronike, forumet online, dhe platformat e tjera digjitale manipulon, publikon ose shpërndanë informacion privat për personin tjetër, pa pëlqimin e tij, për të ekspozuar dhe turpëruar viktimën, ku përmes këtyre veprimeve bëhet i mundur lokalizimin fizik i viktimës dënohet me gjobë dhe burgim deri në tri (3) vjet.

Kur vepra penale nga ky nen kryhet ndaj viktimës nën moshën tetëmbëdhjetë (18) vjet, kryesi dënohet me burgim prej tre (3) deri në gjashtë (6) vjet.

**249.10 Shantazhim seksual (“Sextortion”):** Kushdo që përmes përdorimit të TIK-ut, mjeteve elektronike, duke përfshirë por pa u kufizuar në rrjetet sociale, postën elektronike, forumet online, dhe platformat e tjera digjitale përdor imazhe intime, video, ose informacion të ndjeshëm, Falsifikim të thellë për të kërcënuar, shantazhuar, ose për të kërkuar favore seksuale ose përfitime të tjera nga një tjetër person, duke përdorur kërcënime për të publikuar, shpërndarë ose zbuluar materialet intime ose informacionin e ndjeshëm denohet me gjobë dhe burgim deri në pesë (5) vjet.

Kur vepra penale nga ky nen kryhet ndaj viktimës nën moshën tetëmbëdhjetë (18) vjet, kryesi dënohet me burgim deri në tetë (8) vjet.

## Harmonizimi i Ligjeve

Pastaj, është thelbësore të harmonizohen ligjet në Kosovë për të adresuar këto çështje dhe për të krijuar një sistem të barabartë dhe të drejtë në të gjitha rastet. Duke pasur parasysh sfidat e ndryshme të dhunës kibernetike dhe abuzimeve me imazhe intime pa pëlqim, harmonizimi i ligjeve do të ndihmojë në sigurimin e mbrojtjes së plotë për viktimat dhe në ndëshkimin e autorëve të këtyre veprimeve. Një kuadër ligjor i unifikuar dhe i qëndrueshëm është thelbësor për të garantuar që të gjitha viktimat të trajtohen në mënyrë të barabartë dhe për të siguruar një sistem të drejtë dhe efektiv të drejtësisë që përputhet me standardet ndërkombëtare.

Në kontekstin e Kosovës, Ligji për Parandalimin dhe Mbrojtjen nga Dhuna në Familje, Dhuna ndaj Grave dhe Dhuna në Baza Gjinore<sup>18</sup>, duhet të plotësohet dhe të harmonizohet me Direktivën e BE-së me qëllim të adresimit të të gjitha formave të dhunës që mund të bëhet përmes TIK-ut si dhe këto vepra të inkriminohen në Kodin Penal të Republikës së Kosovës.

---

<sup>18</sup> [Ligji Nr. 08/L-185](#).